



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

**ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE**

Nr. i Dokumentit: 23.15.1-2016-08

**RAPORTI I AUDITIMIT
PËR RAPORTIN FINANCIAR VJETOR
TË ZYRËS SË RREGULLATORIT TË ENERGJISË
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2016**

Prishtinë, qershor 2017

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga Ganimete Dalloshi - Udhëheqëse e ekipit dhe anëtarën Valmira Jonuzi, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit - Bujar Sejdiu.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	6
2 Qeverisja.....	9
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	12
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit	17
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA.....	18
Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	21
Shtojca IV: Letërkonfirmimi	22

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Raportit Financiar Vjetor të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për vitin 2016, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2016 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit¹, të datës 08/05/2016.

Auditimi ynë është fokusuar në (është dhënë në hollësi në Shtojcën 1):



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2016 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar

Pasqyrat Financiare Vjetore *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.*


Për më gjerësisht shih Pjesën 1.1 të këtij Raporti.

Shtojca II, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Dëshirojmë të falënderojmë Kryesuesin e Bordit dhe stafin e tij për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

¹ Termi “Plani i Jashtëm i Auditimit” është zëvendësim i termit “Memorandumi i Planifikimit të Auditimit”

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



Përgjigja e Kryesuesit të Bordit

Kryesuesi i Bordit ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar

Kemi audituar PFV-të e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRë) për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore.

Baza për opinion

Kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave përgjegjës për qeverisje dhe PFV-të

Drejtori Menaxhues i ZRrE-së është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrolle të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryesuesi i Bordit është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të ZRrE-së.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë një keq-deklarim material kur ekziston. Keq-deklarimet mund të rrjedhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

ZRrE kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048, i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.01/2013;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve; dhe
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK).

Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, me rastin e dorëzimit të draft PFV-ve në Ministrinë e Financave konsiderohet e saktë.

Po ashtu, në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandimet lidhur me PVF-të.

2 Qeverisja

Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për ZRrE-në që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe kontrollet. Në mënyrë të ngjashme, pyetësi i vetëvlerësimit siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes pasqyron një shqyrtim të:

- fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive; dhe
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij Raporti).

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Në raport me vitin paraprak, menaxhmenti i ZRrE-së ka bërë disa përmirësime në aranzhimet e qeverisjes së mirë.

Megjithatë, një numër i proceseve qeverisëse duhet të përmirësohen edhe më tej, për të mbështetur menaxhimin efektiv të aktiviteteve të ZRrE-së. Mbi gjysma e rekomandimeve të auditimit të jashtëm nuk janë zbatuar. Po ashtu, identifikimi dhe menaxhimi i rrezikut për mënjanimin e pengesave të mundshme krahas përmbushjes së objektivave nuk ka arritur të finalizohet deri në fund të vitit 2016.

2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2015 të ZRrE-së ka rezultuar në pesë (5) rekomandime kryesore. ZRrE kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do të zbatohen të gjitha rekomandimet.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2016, vetëm një (1) rekomandim ishte zbatuar, një (1) ishte në proces të zbatimit, ndërsa tri (3) nuk janë zbatuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën III.

Rekomandimi

Çështja 1 – Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga viti paraprak – Prioritet i lartë

E gjetura Ndonëse menaxhmenti ka zbatuar një proces formal të menaxhimit dhe monitorimit të zbatimit të rekomandimeve të vitit të kaluar të Auditorit të Përgjithshëm (AP), nuk është arritur që plani i veprimit të përmbushet. Mbi gjysma e rekomandimeve kanë mbetur të pa zbatuara. Si pasojë, janë përsëritur dobësitë e njëjta në fushën e menaxhimit të pasurisë dhe burimeve njerëzore edhe në vitin 2016.

Rreziku Zbatimi jo i plotë i rekomandimeve ndikon në mos përmirësimin e proceseve operacionale dhe në mos efikasitet të vazhdueshëm organizativ.

Rekomandimi 1 Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë një plan të rishikuar i cili përcakton afatet dhe zyratë përgjegjës për zbatim, si dhe të zbatojë një proces efektiv dhe formal për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të AP-së. Progresi kundrejt planit duhet të rishikohet në mënyrë sistematike dhe të ndërmerren veprime pro-aktive ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit.

2.2 Pyetësori i vetëvlerësimit të komponentëve të MFK-së

MF ka hartuar një pyetësor të detajuar të vetëvlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Ne kemi testuar cilësinë e pyetësorëve të vetëvlerësimit të MFK-së të dorëzuara në Ministri, duke vlerësuar secilën komponentë të pyetësorit. Ne kemi përmbledhur të gjeturat tona për ZRrE-në më poshtë dhe përmbledhja e punës sonë në të gjitha auditimet do të konsolidohet në Raportin tonë Vjetor të Auditimit. Kjo nuk ka për qëllim të japë koment për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vetëvlerësimit por do të pasqyrojë gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për të mbështetur përpjekjet e MF-së në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

Çështja 2 – Pyetësori i vetëvlerësimit – Prioritet i lartë

- E gjetura** Si pjesë e auditimit tonë, i kemi shqyrtuar çështjet kyçe të pyetësorit të vetëvlerësimit në lidhje me pesë komponentët e tij. Auditimi ynë ka identifikuar që ZRrE ende nuk ka vendosur një sistem për menaxhimin e rreziqeve dhe përgjegjësia për zhvillimin e menaxhimit të rrezikut ende nuk është deleguar. Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së kuptimit të rëndësisë së këtij sistemi.
- Rreziku** Mungesa e menaxhimit të rreziqeve redukton mundësinë e menaxhmentit për identifikimin dhe menaxhimin e rreziqeve të cilat ndikojnë në arritjen e objektivave të organizatës.
- Rekomandimi 2** Kryesuesi i Bordit duhet t'i identifikojë shkaqet për vonesat në procesin e menaxhimit të rreziqeve dhe të sigurojë që deri më 1 tetor 2017 do të përcaktohet stafi përgjegjës dhe do të vendosen dokumentet bazë. Procesi i menaxhimit të rrezikut duhet të rishikohet në mënyrë sistematike nga menaxhmenti i lartë.

2.3 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit ZRrE operon dhe sfidat me të cilat përballlet. Kjo përfshin përcaktimin e objektivave/strategjisë dhe raportimet efektive menaxheriale dhe financiare.

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm

ZRrE bazuar në Udhëzimin Administrativ nr. 23/2009, për themelimin dhe funksionimin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm (NjAB) në sektorin publik, nuk i plotëson kriteret për të themeluar këtë njësi. Auditimi i brendshëm është segment i rëndësishëm për të siguruar menaxhmentin e lartë se kontrolle e brendshëm janë dizajnuar mirë dhe zbatohen në mënyrën e duhur.

Kryesuesi i Bordit në ZRrE-së ka kërkuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës të sigurojë shërbimin e auditimit të brendshëm por një gjë e tillë nuk është realizuar.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë për MFK-në jashtë fushave të qeverisjes të përmendura në kapitullin dy, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Menaxhimi financiar dhe kontrolli efektiv kërkojnë procese të rishikimit dhe udhëzues përcjellës të cilët sigurojnë zbatimin e plotë të ligjeve, rregulloreve të brendshme dhe proceseve të tjera të kontrollit. Në kontekst të sistemeve financiare ZRrE ka vendosur kontrolle të mira mbi të hyrat dhe shpenzimet në përgjithësi por kontrollet lidhur me menaxhimin e personelit dhe pasurive kërkojnë përmirësim të mëtutjeshëm.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar të hyrat e arkëtuara, burimet e fondeve buxhetore, si dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike.

Të hyrat e gjeneruara nga ZRrE në vitin 2016 ishin 1,573,000€. Shuma prej 678,711€ (të hyra të dedikuara) ishin lejuar të shpenzoheshin për nevojat e ZRrE-së. Pjesa e mbetur e të hyrave të arkëtuara janë transferuar në Buxhetin e Kosovës.

Tabela 2. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Burimet e Fondeve:	743,516	690,938	678,711	544,150	539,519
Granti i Qeverisë - Buxheti	743,516	690,938	678,711	544,150	539,519

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte më i ulët për 52,578€. Kjo është si rezultat i vendimeve të Qeverisë.

Në vitin 2016, ZRrE ka përdorur 98% të buxhet final ose 678,711€, me një rritje prej 2% krahasuar me vitin 2015. Realizimi i buxhetit mbetet në nivel të kënaqshëm dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

² Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga MF.

Sqarimet lidhur me ndryshimet në buxhetin final të ZRrE-së janë dhënë poshtë tabelës 3.

Tabela 3. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	743,516	690,938	678,711	544,150	539,519
Pagat dhe Mëditjet	476,184	453,490	442,487	336,277	307,217
Mallrat dhe Shërbimet	199,332	176,982	176,577	189,001	174,611
Shërbimet komunale	22,000	17,937	17,119	18,872	18,729
Investimet Kapitale	46,000	42,529	42,528	-	38,962

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillestar është zvogëluar për 22,694€ me vendim të Qeverisë. Buxheti për këtë kategori për vitin 2016 është shpenzuar 98%. Shpenzimet në këtë kategori në raport me vitet paraprake janë rritur si rezultat i rritjes së numrit të stafit;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime në raport me buxhetin fillestar është zvogëluar për 22,350€. Zvogëlimi është bërë me vendim të Qeverisë. Ngjashëm ishte zvogëluar edhe buxheti për shpenzime komunale për 4,063€;
- Buxheti final për investime kapitale në raport me buxhetin fillestar është zvogëluar për 3,741€ me vendim të Qeverisë ndërsa është shpenzuar 100%.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga ZRrE në 2016 ishin në vlerë 1,573,000€. Ato kanë të bëjnë me taksa vjetore të licencimit për gjenerim të ngrohjes, taksë vjetore e licencimit për gjenerim të energjisë elektrike, taksë për energjinë e importuar dhe taksë për shqyrtim të aplikacionit për autorizim për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga panelet fotovoltaike. ZRrE ka vendosur kontrolle efektive për të siguruar menaxhimin e të hyrave në pajtim me rregullat financiare dhe kërkesat tjera ligjore.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar (Payroll). Kontrollat kyçe që e konfirmojnë saktësinë dhe plotësinë e pagesave janë të vendosura dhe kanë funksionuar në mënyrë efektive. Numri i aprovuar i stafit në ZRrE ishte 33, ndërsa numri aktual i të punësuarve në fund të vitit 2016 ishte 31 punonjës. Kontrollat lidhur me procesin e rekrutimit janë përcjellë me dobësi siç është prezantuar në vijim.

Çështja 3 – Procesi i rekrutimit – Prioritet i lartë

E gjetura Udhëzimi për Marrëdhënie të Punës (neni 5) përcakton që përzgjedhja e kandidatëve gjatë një procesi të rekrutimit bëhet përmes testit dhe intervistës. Auditimi ynë ka identifikuar që për pozitat ‘Receptionist’ dhe ‘Ekspert i Bazave të të Dhënave’ nuk ishte realizuar testimi me shkrim por vetëm intervistimi i kandidatëve. Sipas zyrtarëve të administratës, kjo ka ndodhur për shkak se për këto pozita kërkohet të vëzhgohen aftësitë e komunikimit.

Udhëzimi për Marrëdhënie të Punës (neni 5) po ashtu përcakton strukturën e testit me shkrim që përbehet nga tri pjesë: pjesa e njohurive të përgjithshme, pjesa e pyetjeve të aftësive të përgjithshme dhe personaliteti si dhe pjesa me pyetje që lidhen me vendin e punës. Ne kemi vërejtur se në procesin e rekrutimit për pozitën ‘Asistente e Bordit’ në testin me shkrim është testuar vetëm gjuha angleze.

Rreziku Dobësitë e paraqitura në proceset e rekrutimit reduktojnë konkurrencën dhe mund të rezultojë me angazhim të personave jo të duhur në pozitat e caktuara.

Rekomandimi 3 Kryesuesi i Bordit duhet t’i analizojë arsyet pse kontrollat e rekrutimit nuk kanë funksionuar dhe t’i forcojë ato për të siguruar një proces të rregullt dhe në pajtim me kërkesat ligjore. Proceset e rekrutimit duhet të ofrojnë bazë për konkurrencë dhe trajtim të barabartë për të siguruar përzgjedhje të stafit profesional.

3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime duke përfshirë edhe shërbimet komunale ishte 194,919€ ndërsa ishin shpenzuar 193,696€ apo 99%. Në këto shpenzime përfshihen shpenzimet përmes procedurave të prokurimit dhe shpenzimet pa procedura të prokurimit siç janë komunalit, avancet, shpenzimet e telefonisë, etj. Shpenzimet dhe procedurat e prokurimit për mallra dhe shërbime ishin realizuar në pajtueshmëri me rregullat financiare dhe kërkesat e prokurimit publik.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.4 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 42,529€ dhe ishte shpenzuar në tërësi. Shpenzimet në këtë kategori ishin realizuar për projekte në teknologjinë informative. Ndonëse procedurat e prokurimit kryesisht ishin në pajtueshmëri me Ligjin e Prokurimit Publik, disa aspekte të kontrolleve nuk ishin efektive.

Çështja 4 – Mungesa e planit për menaxhim të kontratës – Prioritet i mesëm

E gjetura	Sipas Ligjit Për Prokurim Publik (neni 81), Autoriteti Kontraktues duhet që si pjesë e aktivitetit të prokurimit të hartojë një plan për menaxhim të kontratës. Auditimi ynë ka identifikuar që për kontratën “Furnizim me pajisje për TI – Server” nuk ishte hartuar plani për menaxhim të kontratës. Kjo ka ndodhur si pasojë e mos funksionimit efektiv të kontrollit të brendshëm.
Rreziku	Mungesa e planit për menaxhimin e kontratës mund të rezultojë me performancë të dobët të operatorit ekonomik dhe jo sipas kushteve të kontratës. Për më tepër, rrezikohet vlera për para dhe arritja e objektivave të përcaktuara.
Rekomandimi 4	Kryesuesi i Bordit t’i forcojë kontrollet e prokurimit publik dhe të sigurojë që për çdo kontratë të hartohet plani i menaxhimit të kontratës, në mënyrë që të zbatohen kërkesa ligjore.

3.2 Pasuritë

3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Vlera e pasurive jo financiare kapitale (mbi 1,000€) e paraqitur në PVF ishte 86,979€ ndërsa vlera e pasurive jo kapitale (nën 1,000€) ishte 33,781€ si dhe stoqet në vlerë prej 3,818€. Testet tona shpalosen mangësitë si në vijim.

Çështja 5 – Dobësi në menaxhimin e pasurisë – Prioritet i mesëm

E gjetura	Ndonëse vlera e pasurive është e saktë, ekzistojnë disa papajtueshmëri me Rregulloren për menaxhimin e pasurive si në vijim: <ul style="list-style-type: none"> • Blerjet e pasurive për vitin 2016, në vlerë prej 54,102€ ishin regjistruar në SIMFK por nuk ishin regjistruar në regjistrin e përgjithshëm të pasurisë të ZRrE-së siç kërkohet me Rregullore. Po ashtu edhe regjistri e-pasuria për evidentimin e pasurive me vlerë nën 1,000€ nuk është funksional në ZRrE. Këto kanë ndodhur për shkak të vlerësimit se një gjë e tillë nuk është e nevojshme respektivisht për shkak të vështirësive në përdorimin e programit e-pasuria;
------------------	---

- Sipas Rregullores, zhvlerësimi llogaritet në baza mujore dhe pasuria nuk zhvlerësohet për muajin e blerjes. Në regjistrin e pasurive në 33 raste kemi vërejtur që nuk është bërë zhvlerësimi adekuat i pasurisë, duke shkaktuar nënvlerësim të saldosh të pasurive në vlerë prej 305€; dhe
- Sipas Rregullores, 'raporti i inventarizimit' duhet të përmbajë gjendjen fizike të pasurisë jo financiare, kushtet e ruajtjes së tyre dhe vërejtjet mbi karakterin e diferencave dhe dëmtimeve të konstatuara. Komisioni për inventarizim të pasurive në ZRrE, kishte hartuar një raport përshkrues, mirëpo nuk kishte hartuar një raport detal lidhur me gjendjen e pasurive ashtu siç kërkohet me Rregullore.

Rreziku

Mos azhurnimi i regjistrin të pasurisë, zhvlerësimi jo i saktë i pasurive dhe raportet jo në pajtim me kërkesat e Rregullores mund të mos i ofrojë menaxhmentit të gjitha informatat e nevojshme lidhur me gjendjen e pasurive. Në anën tjetër kjo mund të rezultojë me dëmtim dhe/apo humbje të pasurisë dhe prezantim jo të duhur në PVF.

Rekomandimi 5

Kryesuesi i Bordit duhet të rishikoj kontrollet ekzistuese dhe të forcojë ato për të siguruar që dobësitë e identifikuara do të eliminohen deri më 1 tetor 2017. Regjistri i përgjithshëm i pasurive duhet të azhurnohet dhe raportet lidhur me pasuritë duhet të hartohen në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e Rregullores.

3.2.2 Të arkëtueshmet

ZRrE në PVF-të 2016 ka shpалosur llogari të arkëtueshme në vlerë 35,197€. Në krahasim me vitin 2015, të arkëtueshmet në vitin 2016 janë rritur për 7,256€.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.3 Obligimet e papaguara

ZRrE ka shpалosur obligimet e papaguara në PVF-të e vitit 2016 në përputhje me Rregullën Financiare nr. 02/2013 për Raportimin e Obligimeve të Papaguara të Organizatave Buxhetore. Vlera e obligimeve të shpалosura është 11,079€. Këto obligime i takonin muajit dhjetor 2016 dhe janë bartur për t'u paguar në vitin 2017.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuar të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë - Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
Rekomandimet e vitit 2015	Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë që plani i veprimit, i rishikuar, të përcaktojë saktë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e rekomandimit lidhur me menaxhimin e pasurisë.		Përkundër progresit në zbatimin e rekomandimeve të AP-së, mangësi të njëjta janë prezentë në menaxhimin e pasurive dhe në procese të rekrutimit.	
Qeverisja e mirë	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se ka hartuar planin vjetor të punës për të mundësuar monitorimin e progresit dhe vlerësimin e rezultateve të arritura.	Po		
Qeverisja e mirë	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se ka hartuar regjistrin e rreziqeve si operative ashtu edhe financiare si mjete të cilat testojnë efektivitetin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në përkrahjen e objektivave të tyre të punës.			Nuk janë marrë masa.
Paga dhe mëditje	Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë që respektohen të gjitha procedurat për përzgjedhjen e kandidatëve në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi.			Nuk janë marrë masa.
Pasuritë kapitale dhe jo kapitale	Kryesuesi i Bordit duhet t'i rishikoj kontrollet ekzistuese në menaxhimin e pasurisë. Kontrollat në këtë fushë duhet të forcohen në mënyrë që pasuritë të ruhen nga humbja keqpërdorimi.			Nuk janë marrë masa.

Shtojca IV: Letërkonfirmimi

	<p>Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo</p> <p>ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI REGULATORNI URED ZA ENERGIJU ENERGY REGULATORY OFFICE</p>	
<p>LETËR E KONFIRMIMIT</p> <p>Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2016 dhe për implementimin e rekomandimeve</p>		
<p>Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit</p>		
<p>Të nderuar,</p>		
<p>Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:</p>		
<ul style="list-style-type: none">• kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2016 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");• pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe• brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.		
<p>z. Arsim Janova,</p>		
<p>u.d. Kryesues i Bordit të ZRRE-së</p>		
<p>Data: 10.06.2017</p>		